

Serbia vendi i tmerrit dhe jo i ligjit

Robert Elsie, studiues kanadez i letërsisë shqiptare, këto ditë vizitoi redaksinë e KOHËS dhe biseduam për problemin e inkuadrimit të shqiptarëve në mediumet gjermane, për mundësinë e infiltrimit të librit dhe letërsisë shqiptare në mediumet dhe letërsinë evropiane, për neglizhencën shqiptare, për gabimet politike, për Kadarenë dhe polarizimet në Tiranë, për përkthimet e reja, për Qosjen dhe veprën e tij, për shkrimtarët e rinj, për rezistencën.

[BH]: Zoti Robert, një kohë të gjatë merreni me problemet e shqipes dhe me shqiptarëve në përgjithësi. Jeni studiues i zellshëm dhe njëherit jeni mik i shqiptarëve. Në një kontinuitet kohor, si e shihni problemin shqiptar në këto hapësira?

[RE]: Para se fillova të merrem me problemet e gjuhës shqipe, normalisht se isha detyruar të mësoj gjuhën tuaj. Fillova këtu në Kosovë kur merrja pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën shqipe. Ketë e bëra vite me radhë dhe jo vetëm për të mësuar gjuhë por seminari ishte një pikëtakim për shkencëtarët, albanologët dhe të interesuarit në bote. Duke mesuar gjuhën, njëkohësisht u interesova për kulturën shqiptare. Pata mundësi ta vizitoj Shqipërinë përmes Universitetit të Bonit në Gjermani. Botimet e mia i shoh si njëpreentim të kulturës shqiptare në botën e jashtme. Përpiqem t'i prezentoj këtë kulturë të panjohur botës së jashtme, si Amerikës, Evropës etj. Shqipëria dhe tokat shqiptare janë një boshllëk në hartën e Evropës, nuk dihet fare apo fare pak për to. Tash më shumë natyrisht, por në kohën kur fillova interesimet ishte tokë e panjohur fare.

[BH]: Thuani se ishte tokë e panjohur në Evropë. Nga kjo perspektivë cilat ishin arsyet që shqiptarët ishin aq larg Evropës?

[RE]: Arsyet ishin të ndryshme. Kuptohet, diktatura komuniste në Shqipëri nuk lejonte kontaktet me botën e jashtme. Vizitat ishin të ndaluara. Shqiptarët nuk komunikojnë me botën dhe as që insistonin ta bënin këtë. Këtu në Kosovë problemi ishte diç tjetër. Megjithatë, Kosova ishte më e lirë, por ishte e largët dhe e varfër, ndërkaq kontaktet asnjëherë nuk ishin të bollshme. Tani, siç e dini, situata ka ndryshuar thellësisht. Shqipëria është hapur dhe dëshiron kontaktet me botën sa më shumë. Kosova tani është e mbyllur dhe e rrethuar. Këtë e dini Ju më së miri.

[BH]: Thatë se Kosova është e mbyllur dhe e rrethuar. Si e shihni Ju këtë problem, si e shohin ata në Evropë dhe shtetet të cilat i keni vizituar së voni?

[RE]: Und nuk mund t'ju jap një mendim zyrtar, por them se problemi i Kosovës është i njohur. Për çdo veprim e për çdo ngjarje dëgjohet e lexohet. Në kohën e fundit tronditemi sidomos në që merremi me problemin dhe kulturën shqiptare. Është e tmerrshme kur degjojmë për pushtimin e Institutit Albanologjik. Kjo tregon një pabesi nga ana e autoriteteve serbe dhe një primitivizëm të paparë deri tash. Ky Institut nuk kishte asnjë interes ushtarak, asnjë rëndësi strategjike për pushtetin serb. Ishte vetëm një hap i qartë i

Serbisë për ta parandaluar rritjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Është pjesë e fushatës, sipas bindjes sime, e fushatës për pastrimin e heshtur etnik.

[BH]: Megjithatë, reagimet e instituteve kulturore simotra në botë janë fare të pakta me rastin e gjenocidit kulturor në Kosovë. Pse zëri i këtyre institucioneve është aq i zbehtë kur dihet se për shqiptarët këto institucione janë aq të rëndësishme për zhvillimin dhe kultivimin e gjeneratave dhe, njëkohësisht, për zhvillimin në kontinuitet të kulturës shqiptare?

[RE]: Përshtypja ime rreth këtyre problemeve qëndron në këto arsye. Dëgjojme çdo ditë lajme nga Bosnja dhe ngopemi me lajmet nga atje. Tmerret e Bosnjes janë në plan të parë, kështu që shumica e lexuesve dhe shikuesve të televizionit s'kanë fare interes për gjërat që janë më larg se Bosnja. Kosova akoma është me qetë, situata nuk është aq urgjente. Ndoshta për këtë arsye problemet e Kosovës nuk kanë jehonë të madhe.

[BH]: Por, ne, megjithatë, po përjetojmë gjenocidin më të tmerrshëm, i cili, për shumë arsye është pak i heshtur. Mos është në pyetje propaganda e varfër që bëjmë ne, apo mosinteresimi juaj për problemin shqiptar?

[RE]: Me siguri se problemi kryesor është mungesa e propagandës. Unë pas çdo vizite në Kosovë kam insistuar dhe theksuar rëndësinë e kontakteve. Rëndësinë e përkthimeve të ngjarjeve të ndryshme. Kontaktet me telefon, faks dhe me çdo lloj mjeti komunikues. Këtë duhet bërë me institucionet e shtypit perëndimor. Në të kaluarën mungonin fare. Tani, sa kuptoj dhe lexoj unë, ju bëni mjaft në prezentimin e problemeve të Kosoves, por kjo është fare pak në raport me situatën që keni.

[BH]: Ju keni përkthyer disa herë në mes delegacioneve gjermane dhe atyre shqiptare. Cilat janë premisat kryesore të bisedave dhe çfarë mund të vërehet tani nga kultura politike e shqiptarëve.

[RE]: Unë jam përkthyes i Qeverisë gjermane për gjuhën shqipe. Kuptohet, unë kam qenë kryesisht në Shqipëri sepse pak delegacione qeveritare kanë ardhur këtu në Kosovë. Problemet në Shqipëri janë të ndryshme nga problemet e juaja këtu. Atje janë në pyetje problemet ekonomike. Në Kosovë është problemi statusor politik. Për marrëdhënie midis Gjermanisë dhe Kosovës më mirë do të ishte të bisedonit me politikanët gjermanë që ata të jepnin një mendim zyrtar, por e di se në qarqet politike në Gjermani problemi i Kosovës është relativisht i njohur.

[BH]: Mirëpo, pse nuk është aktualizuar?

[RE]: Pse? Pyetja është e drejtë. Nuk e di, por jam tepër i shqetësuar. Kam shumë miq këtu dhe e njoh problemin. Por një gjë është e sigurtë se midis Kosovës dhe Gjermanisë është një Bosnjë-Hercegovinë. Kjo ndoshta pengon një shikim të qartë për problemin e Kosovës.

[BH]: Duke abstrahuar Bosnjën si problem kryesor, megjithatë, Kosova përjeton tmerrin e brutalitetit primitiv. As kjo nuk është prezente sa duhet në mediumet gjermane përveç në Radion “Dojçe Velle” që transmeton një emision në gjuhën shqipe. Duke marrë parasysh të gjitha keto fakte, çka mendoni si duhet dhe çka duhet të veprojnë shqiptarët për ta ringjallur problemin e aktualizuar?

[RE]: Po. Lidhjet e shumta me gazetarë të huaj. Është mirë të vijmë sa më shumë gazetarë e sa e di unë nuk vijmë shumë. Nuk marrin një vizë të vetme. Dëgjova këto ditë se gazetarët e Dojçe Vells nuk morën vizë nga autoritetet serbe dhe të gjithë ata u plaçkitën në kufi. U plaçkitën nga Dogana serbe, më duket në Han të Elezit. I'u morën të gjitha të hollat. I'u morën të gjitha instrumentet e nevojshme. Ky është realitet. Mungon propaganda aktive edhe pse diç po lëviz, por mungesa e arbitrit të medimeve të jashtme është rezultat i veprimit të zbehtë të propagandës suaj. Nuk e di a keni përkthyes, por e di se asnjë libër, dokumente që lëvizin politikën dhe mediumet nuk u janë të njohura as medimeve e as Qeverisë gjermane. Në ato kontakte të rralla që keni, i shfrytëzoni për opzione politike që pa shpjegimin e shëndoshë të çështjeve nuk janë të mjaftueshme. Në një takim gjysëmorësh nuk mund të thuhet të gjitha problemet e grumbulluara në Kosovë. Prandaj, më thuani ju çfarë keni bërë në këtë drejtim. Shumë pak. Mos të themi asgjë. Po them për Gjermaninë. Nuk di për përkthimet në gjuhë të tjera. Këtu qëndron esenca e problemit.

[BH]: Para se të fillonim bisedën, paraqitët një detaj interesant në mes të delegacionit gjerman dhe atij shqiptar. Na thuani si po prezentohen shqiptarë në këto takime/

[RE]: Gjendja në Tiranë po përmirësohet dukshëm. Para një kohe isha prezent në një takim zyrtar në mes Qeverisë gjermane dhe asaj shqiptare. Përfaqësuesi i Qeverisë shqiptare, duke dashur të theksojë miqësinë në mes Gjermanisë dhe Shqipërisë, theksoi shprehimisht “racën tonë të përbashkët ariane.” Delegacioni gjerman u shtang, ishin të habitur dhe nuk reagonin fare sepse ariani është fjalë fashiste nga koha e Hitlerit. Gjermanët ishin krejtësisht të habitur. Ishte ky një gabim i rëndë nga ana e përfaqësuesit shqiptar. Kjo ka ndodhur në Shqipëri disa herë. Nëpër ministri nuk kanë qenë shpeshherë aq të denjë për të prezentuar kërkesat urgjente të Shqipërisë. Në kohët e fundit gjendja është paksa më e mirë dhe punojnë me disa nëpunës më të aftë në ministri.

[BH]: Në një simpozium në Prishtinë, atëbotë, patët folur për problemet e veprave të përkthyer nga gjuha shqipe. Sa janë shqiptarët me vepra të përkthyer nga ajo kohë kur Ju kritikuat ashpër neglizhencën e intelektualëve shqiptarë në këtë drejtim?

[RE]: Letërsia shqiptare ka qenë krejtësisht e sabotuar nga regjimi komunist në Shqipëri. Për të botuar në Tiranë, kriter ka qenë përmbajtja nga jeta e realizmit social dhe kryesisht ato ishin vepra të dobëta. Përkthimet ishin shumë të dobëta apo nuk lexoheshin fare. Lexuesi që ndoshta kishte një interes për letërsinë shqiptare hapte librin dhe e mbyllte menjëherë sepse ishte i palexueshëm. Veprat më të mira të letërsisë shqiptare nuk u përkthyen fare. Tani së fundi situata ka ndryshuar, por mungojnë akoma përkthyesit në gjuhën shqipe që janë në gjendje të përkthejnë veprat më të mira nga shqipja në gjuhë botërore. Unë përpiqem të prezentojë letërsinë shqiptare. Vitin e kaluar kam botuar një

Antologji të poezisë bashkëkohore shqiptare. Atë e bëra në anglishte dhe ajo u botua në Londër. Kam përfshirë 25 poetë ku ndihmën kryesore e dha UNESCO-ja. Gjithashtu, kam përkthyer veprat poetike të Migjenit në anglishte dhe gjermanishte dhe po vazhdoj përkthimet e prozës. Sa i përket letërsisë së Kosovës, nuk është bërë shumë apo është bërë fare pak. Në Gjermani janë përkthyer vepra e Ali Podrimjes, autor dhe poet i njohur dhe shpresoj se së shpejti do të na vijë për një vizitë. Shkrimtarët e tjerë janë gati të panjohur. Në frëngjishtë është botuar për herë të parë libri i Rexhep Qosjes: *Vdekja më vjen prej syve të tillë* që po pritet shumë mirë në Francë dhe shpresoj që do të vijë edhe botime e tjera nga Kosova.

[BH]: Pohoni se letërsia shqiptare është fare pak prezente në Evropë. Cilat kritere duhet përmirësuar me qëllim që shkrimtarët shqiptarë të jenë prezentë sa më shumë në Evropë?

[RE]: Pengesa nuk gjendet në cilësinë e letërsisë shqiptare, megjithatë ka shumë botime të pavlerë fare. Kjo i ka dhënë një shtytje negative letërsisë shqiptare dhe së fundi prezentimeve të mëparshme u duhet një kualitet i ri për t'i përmirësuar bindjet. Nuk kemi as dorëshkrime të mjaftueshme ku mund të përkthehen dhe njëkohësisht përkthyes të mirë, gjë që pengon kontaktet midis kulturave. Këtu qëndron problemi kryesor. Nuk është ndoshta krejt mungesa e cilësisë sepse gjendjen aty-këtu vepra të cilësisë së mirë. Kam fjalën për tregimin e Ismail Kadaresë *Krushqit janë të ngrirë*, vepra shumë interesante që kap problemin e Kosovës dhe i tregon lexuesit jashtë për atë problem, së paku aty nga fillimi i viteve të tetëdhjeta. Është përkthyer në frëngjisht dhe lexuesit e vendeve të tjera nuk e njohin. Do të ishte me shumë rëndësi që kjo vepër të përkthehet edhe në disa gjuhë të tjera, por ç'e do kur faji është te ju e jo te lexuesit.

[BH]: Thatë se keni ardhur për të shikuar se çka është botuar në Kosovë kohëve të fundit. Fillimisht ju informojmë se tek ne, në mungesë të institucioneve, kanë rënë kriterët e botimeve. Çfarë janë përshtypjet tuaja nga koha kur ishit për herë të fundit në Kosovë?

[RE]: Unë mendoj se shtëpitë botuese private janë gjë e mirë dhe ndoshta është ironike por është e vërtetë se me përzënie e shqiptarëve nga institucionet botuese, autorët ishin të detyruar të dalin me botime private. Do të pasojnë patjetër botimet cilësore. Gjendja ekonomike pengon kultivimin e mirëfilltë kulturor, botues dhe artistik. Kuptohet, njerëzit nuk kanë shumë para për të blerë edhe pse shoh se mjaft ka ndryshuar struktura ekonomike e njerëzve, por është e sigurt se të tillët nuk janë ata që blejnë dhe sponsorizojnë librat. Ata që kanë dëshirë ta bëjnë këtë dhe t'i blejnë ato nuk kanë mundësi materiale. Kjo do të arrihet me kohë. Transformimet kulturore janë gjithëkund të rënda dhe me përjetime të rënda. Por, ç'e do kur fati juaj është ta përjetoni këtë tranzicion nacional si në politikë, kulturë, art dhe në çdo fushë tjetër.

[BH]: Thatë, gjithashtu, se po botoni letërsinë shqiptare në 1000 faqe. Çka përfshin ky libër?

[RE]: Ky libër është mjaft i madh dhe është si një përbindësh për mua. Tashti do të botohet në anglishte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përfshin gjithë letërsinë shqiptare që nga fillimi e deri në ditët e sotme. Përfshin letërsinë e Kosovës dhe të

arbëreshëve. Ka kapituj të veçanta për letërsinë e Rilindjes, për letërsinë me frymë myslimane dhe bektashiane, për letërsinë arbëreshe që nga fillimi deri në fund. Kemi letërsinë shqiptare para luftës. Do të përpiqem të përfshijë të gjitha veprat që kanë kualitet dhe prezentojnë diçka.

[BH]: Është një periudhë 50 vjeçare që letërsia shqipe, megjithatë, doli me disa emra. Si e keni përfshi atë periudhë të errët të letërsisë shqiptare nën diktaturën komuniste, e cila zbehu të gjitha periudhat e ndritshme të letërsisë shqiptare?

[RE]: Nga periudha e realizimit socialist kam prezentuar të gjitha veprat. Edhe ato të dobëtat edhe ato të mirat, që fatkeqësisht janë të pakta. E kam prezentuar në mënyrë realiste, të paktën. Kjo periudhë nuk duhet harruar krejtësisht. Duam apo jo, është bërë pjesë përbërëse e letërsisë shqiptare. Edhe pse ishte periudhë e rëndë, e gjithë kjo nuk fshihet nga faqet e historisë dhe letërsisë shqiptare. Unë e prezentova sipas bindjeve të mia. Kuptohet, ishte një periudhë mjaft e vështirë me shumë botime të cilësisë së dobët. Letërsia shqiptare nuk arriti ndonjë kulm, por u afirmua si letërsi ekzistuese evropiane.

[BH]: Ismail Kadare është i pari në këtë periudhë, pas Faik Konicës dhe Nolit, që shkeli në dyert e Evropës. Si qëndron pozita e Kadaresë në letërsinë botërore dhe, konkretisht, në letërsinë evropiane?

[RE]: Në fillim, duhet të flitet për Ismail Kadarenë më shumë në kuadër të letërsisë shqiptare. Këtu ka një pozitë të lartë dhe në krahasim me shumë autorë të tjerë është një kolos letërsie shqiptare. Kjo është një e vërtetë që nuk duhet mohuar. Në kuadër të letërsisë evropiane është më vështirë të thuhet. Ismail Kadareja është autor i njohur, shumë i njohur në Francë. Kurse në Angli, Amerikë dhe Gjermani nuk është i njohur fare. Botimet e tij nuk lexohen shumë në Amerikë. Ka disa botime të botuara në anglishte, por është autor i njohur kryesisht në Francë. Kadare cilësohet, së fundi, për fat të keq, më shumë si autor politiko-shoqëror. Nga pikëpamja jo letrare nuk mohohet fakti se ai ka mjaft armiq në Shqipëri, por ka edhe miq. Fitohet përshtypja se qarqet letrare të Tiranës janë të polarizuara në dy drejtime: në miq të Ismailit dhe armiq të tij. Po kjo është më shumë politika e ditës në Tiranë. Unë, për vetën time, përpiqem ta trajtojë nga pikëpamja letrare. Unë e cilësoj si shkrimtar i madh.

[BH]: Tani së fundi jeni më shpesh në Shqipëri. Fitohet përshtypja se atje ka shkrimtarë të rinj që meritojnë të përkthehen në gjuhët evropiane. Cila është përshtypje juaj për autorët e rinj shqiptarë?

[RE]: Tani është heret të thuhet. Në Shqipëri kanë dalur shumë shkrimtarë të rinj. Kryesisht me poezi. Nuk janë të gjithë të kualitetit, por dallohen disa që vlejné të përkthehen. Ndodh një fenomen atje. Ai që ka para mund të botojë, kurse ai që nuk ka nuk mund të botojë. Nuk varen gjithmonë nga cilësia. Kohëve të fundit nuk më ra në sy diçka e veçantë që duhet patjetër të përkthehet. Megjithatë, ndoshta nuk jam në dijeni për të gjitha veprat e botuara. Këtu në Kosovë erdha për të gjetur libra, të shoh se ç'ka të re nga botimet. Nuk mund të them akoma asgjë. Do ta them këtë pasi të mbledhë të gjitha botimet e pastaj mund të japë vlerësimin.

[BH]: Së fundi, çfarë iu duhet shqiptarëve urgjentisht të veprojnë në letërsi dhe gjithashtu në politikë, sepse e tërë ajo që ndodh tek ne ka konotacion politik?

[RE]: Shqiptarët duhet bërë dy gjëra kryesore: kontaktin me botën, që ka shumë rëndësi, dhe arsimimin. Po flas në fillim për Shqipërinë: Shqipëria tashti është vendi i hapur, dhe më shume të rinj duhet të dalin, të shkojnë në Amerikë, në Evropë, të mësojnë gjuhë të huaja, të mbledhin përvojat e tyre dhe t'i kthejnë në atdhe. Kosova ka pasur gjithmonë njerëz jashtë por kryesisht punëtorë që është dashur t'i ushqejne familjet e tyre me punë të rëndë. Ka pasur pak studentë. Sa i përket sistemit arsimor si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë ka qenë mjaft i dobët. Në Shqipëri për shkak të diktaturës, në Kosovë për arsye të situatës politike dhe mungesës së vullnetit të mirë nga regjimi serb dhe pushteti i Beogradit i cili nuk dëshironte që shqiptarët të kenë sistem të lartë shkollimi me çka do të hynin në Evropë. Ata preferonin të ketë shqiptarë fshatarë të thjeshtë, pa shkollë, sepse është më thjeshtë t'i kontrollosh njerëzit e tillë. Shqiptari rural dhe i pa shkollë shumë lehtë mund të bindet për të gjitha ato që i ofron një sistem politik e sidomos ky serb, që është i perfeksionuar në kontinuitet për asimilim dhe hegjemoni.

Kjo është një llojë blokade që duhet çarë me çdo kusht. Nga të gjitha gjërat që janë me rëndësi, arsimi është ai i cili sa më parë duhet të rivendoset.

[BH]: Dhe së fundi?

[RE]: Unë jam këtu për herë të parë nga viti 1989. Erdha me një hezitim sepse flitet për Serbinë si në atë kohë kur flitej për Gjermaninë naziste. Një vend i tmerrit, një vend me ushtarë me automatikë, një vend pa ligj, pa mbrojtje të të drejtave të njeriut. Habitem, në fakt, se me çfarë durimi dhe me çfare kuptueshmërie shqiptarët e durojnë këtë situatë. Po të ishte gjë natyrale dhe e zakonshme, kjo nuk do të mund të bëhej. Jam i bindur se kjo është madhështi e cila, ndoshta, do të japë fryta. Nuk duhet dorëzuar fare. Kjo, megjithatë, është tragjedi serbe e jo shqiptare. Ata do të ballafaqohen me realitetin e humbësit dhe të tillë çfarë janë – janë tragjike. E tragjikët humbin në mesin e dashamirëve të paqes.

E intervistoi Baton Haxhiu.

[botuar në / published in: revistën *Koha*, Prishtina, 29 qershor/June 1994, p. 10-13, ribotuar në / reprinted in: *Illyria*, New York, 25-27 July 1994.]